





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Procesverbal i takimit të dytë publik buxhetor për buxhetin e vitit 2027, të mbajtur në Bashkësinë Lokale të Qirezit

Data: 20.08.2026

Ora: 15:00

Vendi: SHFMU “Dëshmorët e Qyqavicës” Qirez

Të pranishëm: Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet e Financa z. Behxhet Maliqi, Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, z. Arbnor Çitaku, Drejtoresha e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Ndërmarrësisë, Inovacionit dhe Turizmit znj. Besarta Meha Ademi, Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport znj. Kosovare Ahmeti si dhe qytetarët nga lista pjesëmarrëse e bashkangjitur më poshtë.

Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura: Fjala hyrëse/përshëndetëse – hapja e takimit.

Ne i kemi dëgjimet buxhetore të obliguara me ligj, në kuadër të planifikimit të buxhetit për 3 vitet e ardhshme sidomos për vitin e ardhshëm 2027. I di nevojat dhe kërkesat e Qirezit si: ujësjellësi projekt i cili vazhdon, ndriçimi ka pasë me fillu, mirëpo kontrata kolektive e ka prishë strukturën buxhetore. Mirëpo për më shumë i kemi prezent këtu drejtorët: Drejtori i Financave, i Urbanizmit, i Arsimit, Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik.

Që keni ndonjë kërkesë që ne me evidentu dhe pastaj me shqyrtu gjatë planifikimit në fazat tjera, por fillimisht po ia kaloj fjalën drejtorit të Financave, pastaj vazhdojmë me ju.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet e Financa z. Behxhet Maliqi: Fjala hyrëse. Jemi munduar edhe këtë vit që të bëjmë një buxhet sa me afër nevojave të qytetarëve.

Këtë vit buxheti i Komunës së Skenderajt është 20 milion e 814 e 790 euro, pjesa më e madhe e këtij buxheti është për paga: pagat e arsimit, pagat e shëndetësisë, pagat e punëtorëve të komunës, krejt kategoria e pagave është 12 milion e 252 mijë e 605 euro. 3 milion e 306 mijë e 675 euro janë mallrat dhe shërbimet. 326 mijë e 700 euro pagesa për rrymë, për ujë, për mbeturina në shkolla për obligime të shërbimeve komunale, ndriçim të fshatrave dhe gjithçka çka kem. 1 milion e 10

mijë euro janë për subvencione: subvencionimi në bujqësi, në shëndetësi, bursa. 3 milion e 918 mijë e 810 euro për projektet kapitale.

Kjo ka qenë kërkesa jonë minimale e buxhetit që e kemi dërgu në qeveri, me këtë strukturë. Është kthyer Qarkorja e Dytë ku është ulë për 774 mijë e 671 euro prej projekteve kapitale: kanalizim, ujësjellës, ndriçim publik, prej 3 milion e 918 mijë e 810 euro në 3 milion e 144 mijë e 139 euro dhe janë rritë pagat pra kanë kalu në kategorinë e pagave për këtë shumë, kategoria e pagave është 13 milion e 27 mijë e 275 euro në kurriz të buxhetit të komunës.

Vetëm deri tani, Komunës së Skenderajt nga obligimet e kontratës kolektive, përmbaruesit në këtë vit ia ka marrë 1 milion e 500 mijë euro, janë edhe 300 mijë euro të cilat janë vendim i formës së prerë prej përmbaruesve që e qon këtë shumë në 1 milion e 800 mijë euro mjete financiare dëmin në buxhetin e komunës. Për fillim kaq nga unë, jam i hapur për çdo sqarim të nevojshëm.

Fetah Fetahu – Banor i fshatit Qirez: Fjala hyrëse. Kemi kërkesë për projektet që kanë mbetë pa përfundu si p.sh subqendra, pastaj kemi kërkesë për ndriçimin e lagjeve, trotuarët 2 km gjatësi dhe ujësjellësin aq sa mundeni me arritë për këtë vit.

Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura: Sa i përket subqendrës, është zvarritë për shkak të kontratës kolektive, përmbaruesit i kanë marrë mjetet, por subqendrat janë të projektume me përfundu këtë vit. Trotuari dhe ndriçimin i kemi pasur në planifikim, të kontraktume 1 milion e 400 mijë që i ka marrë prej projekteve përmbaruesi si pasojë e kontratës kolektive. Për ujë, gypsjiellësi vazhdon, është i planifikuar, problemi është me furnizim, pa u kry projekt i Brusit për Komunën mbetet sfida, ajo duhet me përkrahjen e qeverisë.

Albert Rexhepi – Banor i fshatit Qirez: Fjala hyrëse. Po fokusohem në disa çështje që nuk kërkojnë shumë mjete financiare por me një mbikëqyrje më të madhe na lehtësojnë jetën neve si banorë të kësaj ane p.sh në Gofile prerja e rrugës nga KEDS-i dhe nuk e kanë rregullu e njëjta edhe në vende tjera si në hyrje të Polacit, po na sjellë vështirësi, ka mbetë shumë keq. Pastaj edhe mirëmbajtja e rrugëve, hapja e gropave që është bërë ka nevojë për intervenim.

Kërkesë tjetër është për çerdhe sipas planifikimit dhe mundësive buxhetore është e nevojshme. Një çështje tjetër është gurëthyesi, i cili një kohë e ka ndalu minimin, e ka fillu prapë, çështja e mbeturinave, për të cilin kam qenë 100% kundër, po djeg edhe goma, ka qenë premtim i tij mos me bo një gjë të tillë, kam kërkesë që me u mbikëqyr më shumë.

Frashër Xhemaili – Banor i fshatit Qirez: Fjala Hyrëse. Të gurëthyesi digjen të gjitha mbeturinat, na mbulon tymi komplet si lagje. Pastaj selaniti, hudhja e tij në Dell, është 100% kancerogjen. E kemi shqetësim sepse furnizohemi me ujë, ai duhet të izolohet jo vetëm të hudhet dhe të rrezikohet jeta jonë si banorë të këtij fshati. Marrëveshja ka qenë që të mos hudhet çfarëdo mbeturine dhe mos të digjen.

Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura: Po filloj të problemet me rrugë. KEDS-i e ka obligim që t'i kthej rrugët në gjendjen e mëparshme, por duhet me i mbikëqyr. Pastaj pengesat në rrugë me herët kemi marrë vendim që t'i largojmë krejt. Të gurëthyesi, kjo që djegë nuk e kam ditë, inspeksioni e ka obligative që herë pas herë me vizitu, sipas marrëveshjes. Mbeturinat ndërtimore e ka që pas një kohe me i mbulu me dhe, kjo për djegie u identifikua dhe inspeksioni mënjëherë duhet të marrë masa me dënim sepse kemi kompetencë, por na duhet edhe bashkëpunim me

qytetarët, që t'i lajmërojnë këto raste, qoftë me foto apo në forma tjera. Flas dhe me Drejtorin e Inspeksionit dhe do ta mbikëqyrim për këtë pjesë.

Amir Ferati – Banor i fshatit Qirez: Fjala hyrëse. Edhe unë e kam një kërkesë për rregullimin e oborrit të shkollës sepse ka një pamje të vrazhdë dhe një rrethojë.

Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura: Me pasë mundësi me lidhë oborrin e shkollës me subqendër. Jemi keq me buxhet të themi të drejtën, mirëpo qëndro në kontakt edhe me drejtorin dhe sipas mundësive, por jemi në vështirësi buxhetore, gjendja është e rrezikshme, kemi sfida, pa përkrahje nga qeveria.

Gazmend Xhemaili – Banor i fshatit Qirez: Fjala hyrëse. Buxheti po shihet, i dobët, mirëpo a mundet që mos të investohet në ndriçim dhe këto mjete të destinohen në pjesën e shëndetësisë, të pjesa e shërbimeve për analiza mjekësore, sepse miliona euro analiza bëhen në laboratorë privat dhe jashtë komunës, është një kosto shumë e madhe për qytetarët.

Nënkryetari i Komunës z. Fadil Nura: Para dy viteve i kemi mundësuar në QKMF në Skenderaj, analiza që nuk janë bërë me herët. Me pasë mundësi me i realizu të gjitha kërkesat kish qenë mirë, por deri tani këto janë shërbimet dhe mundësitë, ke të drejtë ti sepse rastet shëndetësore janë me humane por sipas mundësive gjithmonë.

Unë i'u falënderoj secilin prej juve për prezencën dhe kërkesat, nëse nuk ka dikush tjetër e mbylli këtë takim.

Procesmbajtëse:

Besjana Thaçi



Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin e dytë buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2027 i mbajtur në Bashkësinë Lokale të Qirezit

Data, vendi dhe ora: E enjte, 20 Gusht 2026 - SHFMU "Dëshmorët e Qyqavicës", Qirez, 15:00

Nr	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nr. telefonit	Nënshkrimi
1	Amir Gëati	Qirez	045 181488	Amir Gëati
2	Albert Rexhepi	Qirez	045 76236	Albert Rexhepi
3	FETAH FETANI	QIREZ	045 777	Fetah Fetani
4	ISAK SMOJLI	GIREZ	045 7177	Isak Smojli
5	GAZMERI XHEMAJLI	QIREZ	045-104451	Gazmeri Xhemajli
6	FRASHER XHEMAJLI	QIREZ		Frasher Xhemajli
7	Sokol Aliu	QIREZ		Sokol Aliu
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				

Fotot e takimit të dytë publik buxhetor për buxhetin e vitit 2027, të mbajtur në Bashkësinë Lokale të Qirezit

